



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 132

Tiranë – E mërkurë, 29 korrik 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 75/2015 datë 9.7.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit Europian për punësimin dhe inovacionin social (EASI)..... 6757
Ligj nr. 76/2015 datë 16.7.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 6760
Ligj nr. 77/2015 datë 16.7.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar..... 6762
Ligj nr. 78/2015 datë 16.7.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes së shërbimit këshillimor financiar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë, dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare..... 6766
Ligj nr. 79/2015 datë 16.7.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes kuadër të huas ndërmjet Këshillit të Ministrave, që përfaqëson Republikën e Shqipërisë, dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës për projektin e rehabilitimit të spitalit rajonal të Shkodrës, faza e tretë..... 6779



LIGJ
Nr. 75/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT
EUROPIAN PËR PJESËMARRJEN
E SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E
BASHKIMIT EUROPIAN PËR
PUNËSIMIN DHE INOVACIONIN
SOCIAL (EASI)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian për punësimin dhe inovacionin social (EaSi), sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 9.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9192, datë 27.7.2015
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË
PROGRAMIN E BASHKIMIT EVROPIAN
PËR PUNËSIMIN DHE INOVACIONIN
SOCIAL (EASI)

Komisioni Evropian, më poshtë referuar si “Komisioni”, në emër të Bashkimit Evropian, nga njëra anë, dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, më poshtë referuar si “Shqipëria”, nga ana tjetër,

duke marrë në konsideratë se:

1. Marrëveshja Kuadër e 26 shkurtit 2002, ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë përcakton parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e BE-së, duke i dhënë autoritet Komisionit dhe autoriteteve kompetente të Shqipërisë për të përcaktuar termat dhe kushtet specifike, duke përfshirë kontributin financiar në lidhje me këtë pjesëmarrje në secilin program të veçantë.

2. Programi i Bashkimit Evropian për Punësim dhe Inovacion Social (EaSI) është hartuar sipas Rregullores së BE-së nr. 1296/2013, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 11 dhjetor 2013.

3. Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Programi

Shqipëria do të marrë pjesë në Programin e Bashkimit Evropian për Punësim dhe Inovacion Social (EaSI) (më poshtë referuar si “Programi”), në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër, të 26 shkurtit 2002, ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e BE-së dhe sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në nenet 2-4 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Marrëveshje dhe kushte mbi pjesëmarrjen
në Program

1. Shqipëria do të marrë pjesë në Program në përputhje me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet e përcaktuara në Rregulloren (BE) nr. 1296/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, dhe në bazë të neneve 16 dhe 27 të Rregullores.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, Shqipëria nuk do të marrë pjesë në aktivitetet e Programit nëse ka kufizime për shkak të kufizimeve ligjore ose rregullatore, ose për shkak të atyre lëndore që do të miratohen nga Komiteti në bazë të nenit 32 të Rregullores (BE) nr. 1296/2013.

3. Termat dhe kushtet e zbatueshëm për paraqitjen, vlerësimin dhe përzgjedhjen e kërkesave nga institucionet, organizatat dhe individët e Shqipërisë, do të jenë të njëjta me ata që zbatohen për institucionet, organizatat dhe individët e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.



4. Për të marrë pjesë në Program, Shqipëria do të paguajë çdo vit një kontribut financiar për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 3 më poshtë. Kontributi financiar i Shqipërisë, në lidhje me pjesëmarrjen dhe zbatimin e programit të saj, do t'i shtohet shumës së caktuar çdo vit në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian për shumat e caktuara të angazhimeve për të përmbushur detyrimet financiare që rrjedhin nga forma të ndryshme të masave të nevojshme për ekzekutimin, menaxhimin dhe funksionimin e Programit.

5. Një nga gjuhët zyrtare të BE-së do të përdoret për procedurat në lidhje me kërkesat, kontratat dhe raportet, si dhe për aspekte të tjera administrative të programit.

Neni 3

Kontributi financiar

Rregullat që drejtojnë kontributin financiar të Shqipërisë janë paraqitur në shtojcën I.

Neni 4

Raportimi dhe vlerësimi

Duke mos cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe Gjykatës Evropiane të Auditëve në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e Programit, pjesëmarrja e Shqipërisë duhet të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme në bazë të partneritetit, duke përfshirë Komisionin dhe Shqipërinë. Shqipëria duhet t'i paraqesë raportin përkatës Komisionit dhe të marrë pjesë në aktivitete të tjera specifike të mundësuar nga BE-ja në këtë kontekst.

Në përputhje me rregulloren (EC Euratom), nr. 1605/2002 të 25 qershorit 2002 dhe nr. 2342/2002 të 23 dhjetorit 2002 dhe rregulla të tjera të përmendura në këtë Marrëveshje, kontratat e lidhura me përfituesit e programeve të themeluara në Shqipëri, duhet të parashikojnë audite financiare dhe kontrolle të tjera, në bazë të dokumenteve dhe të transmetohet menjëherë nga përfaqësuesit e Komisionit ose nga persona të tjerë të mandatuar nga Komisioni.

Përfaqësuesit e Komisionit dhe persona të tjerë të mandatuar nga Komisioni duhet të kenë akses te dokumentet dhe i gjithë informacioni i kërkuar, me qëllim që të kryejnë këto audite, duke përfshirë formatin elektronik. Kjo e drejtë aksesit duhet të

paraqitet shprehimisht në kontrata të lidhura që të zbatohen instrumentet e përmendura në këtë Marrëveshje. Gjykata Evropiane duhet të ketë të njëjtat të drejta si Komisioni.

Neni 5

Dispozitat përfundimtare

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për kohëzgjatjen e programit. Megjithatë, nëse Bashkimi Evropian duhet të vendosë të zgjasë kohëzgjatjen pa ndonjë ndryshim thelbësor në Program/e, kjo marrëveshje duhet të zgjatet, gjithashtu, përkatësisht dhe automatikisht nëse asnjë palë nuk e denoncon brenda një muaji pas vendimit të shtyrjes.

Projektet dhe aktivitetet që janë në vazhdim gjatë kohës së përfundimit duhet të vazhdojnë përmbushjen sipas kushteve të paraqitura si më poshtë në këtë Marrëveshje, si edhe në marrëveshje kontraktuale që zbatohen për këto projekte dhe dispozita të shtojcës II.

Shtojcat formojnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të palëve. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën kur Shqipëria informon Komisionin nëpërmjet rrjetëve diplomatike që miratimi i plotë është përmbushur.

Lidhur më..... në.....

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

[emri]

Ministri i [departamentit ministror]

Shqipërisë

Lidhur më..... në.....

Për Komisionin

Në emër të Bashkimit Evropian

[emri]

Anëtar i Komisionit

Për [portofolin]



SHTOJCA I
RREGULLAT QË RREGULLOJNË
KONTRIBUTIN FINANCIAR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
PROGRAMIN E BASHKIMIT EVROPIAN
PËR PUNËSIMIN DHE INOVACIONIN
SOCIAL (EASI)

1. Kontributi financiar që duhet të paguhet nga Shqipëria në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në Program do të jetë si më poshtë:

50.000 euro për vitin [2014-2016],

100.000 euro për vitin [2017-2020],

[ku 2014 është viti i parë i pjesëmarrjes së mundshme aktuale në program].

Kontributi i Shqipërisë do të mbulojë kostot që lidhen me përgatitjen, fizibilitetin, zhvillimin dhe zbatimin e projekteve me interes të përbashkët, si dhe për zhvillimin dhe për zbatimin e masave horizontale të parashikuara në program.

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit, të kryera nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për qëllimet e marrjes pjesë si vëzhgues në punën e komitetit të përmendur në nenin 36 të Rregullores (BE) nr. 1296/2013, ose takime të tjera që lidhen me zbatimin e programit, rimbursohen nga Komisioni mbi të njëjtën bazë, si dhe në përputhje me procedurat tashmë në fuqi për përfaqësuesit e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

3. Rregullorja financiare e zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian zbatohet për menaxhimin e kontributit të Shqipërisë.

4. Kur kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi dhe në fillim të çdo viti pasues buxhetor, Komisioni i dërgon Shqipërisë një ftesë për fonde që përputhet me kontributin e saj për shpenzimet e mbuluara nga kjo Marrëveshje.

5. Ky kontribut paguhet në euro në një llogari bankare në euro të caktuar të Komisionit.

6. Republika e Shqipërisë do të paguajë kontributin e saj financiar për shpenzimet vjetore në përputhje me ftesën për fonde, jo më vonë se tre muaj pas datës së thirrjes. Çdo vonesë në pagesën e kontributit shkakton pagesën e kamatëvonës nga Shqipëria për shumën e prapambetur nga data e kërkuar. Norma e interesit do të jetë norma e zbatuar nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj kryesore të

rifinancimit, siç publikohet në serinë C të Fletores Zyrtare të Bashkimit Evropian, në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajve kur skadon afati, e rritur me 3.5 pikë për qind. Nëse vonesa në pagesën e kontributit është e tillë që mund të rrezikojë seriozisht zbatimin dhe menaxhimin e programit dhe në mungesë të pagesës 20 ditë pune, pas letrës zyrtare të kujtesës së dërguar nga Komisioni për Shqipërinë, pjesëmarrja e Shqipërisë në program për vitin përkatës do të pezullohet.

SHTOJCA II
KONTROLLI FINANCIAR, RIKUPERIMI
DHE MASA TË TJERA KUNDËR VJEDHJES

I. Kontrolle dhe masa kundër vjedhjes nga Bashkimi

1. Në përputhje me rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian, si dhe me rregullat e tjera të përmendura në këtë Marrëveshje, kontratat dhe marrëveshjet e grantit, të lidhura me përfituesit e programit të vendosur në Shqipëri, mund të parashikojnë auditime financiare apo kontrole të tjera, mund të kryhen në çdo kohë gjatë zbatimit të kontratës ose të Marrëveshjes së grantit dhe për një periudhë pesëvjeçare, duke filluar nga data e pagesës së bilancit.

2. Agjentët e Komisionit dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni do të kenë akses të lejuar në ambientet e kontraktuesve dhe të nënkontraktuesve të tyre dhe në ambientet e përfituesve dhe kontraktuesve dhe nënkontraktuesve të tyre, në kantiere, vende pune dhe dokumentet dhe tek i gjithë informacioni i kërkuar, me qëllim kryerjen e këtyre auditimeve, duke përfshirë formatin elektronik. Kjo e drejtë aksesit parashikohet shprehimisht në kontratat dhe marrëveshjet e grantit, të lidhura për të zbatuar instrumentet e përmendura në këtë Marrëveshje. Gjykata Evropiane e Auditëve ka të njëjtat të drejta me Komisionin.

3. Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni/OLAF-i (Zyra Evropiane kundër Mashtrimit) autorizohet të kryejë kontrole në vend dhe inspektime në territorin e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat procedurale të Rregullores së Këshillit (Euratom, EC) nr. 2185/96 të 11 nëntorit 1996.

Këto kontrole dhe inspektime përgatiten dhe kryhen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet



kompetente të Shqipërisë të caktuara nga autoritetet e [emri i vendit], të cilat do të njoftohen në kohën e duhur mbi objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe të inspektimeve, në mënyrë që të mund të sigurojnë të gjithë ndihmën e nevojshme.

Kur pjesëmarrësit në program kundërshtojnë një kontroll në vend ose inspektimin, autoritetet e Shqipërisë, duke vepruar në përputhje me rregulloret e brendshme, do t'u japin inspektorëve të Komisionit/OLAF-it atë ndihmë që ata kanë nevojë për t'u dhënë atyre mundësinë të përmbushin detyrat e tyre në kryerjen e një kontrolli ose inspektimi në vend.

Komisioni/OLAF-i do të raportojë sa më shpejt të jetë e mundur tek autoritetet e Shqipërisë çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi të identifikuar gjatë kontrollit në terren apo inspektimit. Në çdo rast, Komisionit/OLAF-it i kërkohet të informojë autoritetin e sipërpërmendur për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve.

II. Informacioni dhe konsultimi

1. Për qëllimet e zbatimit të duhur të kësaj shtojce, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe të BE-së do të shkëmbejnë rregullisht informacion dhe, me kërkesë të njëres prej Palëve, do të zhvillojnë konsultime.

2. Autoritetet kompetente të Shqipërisë do të informojnë Komisionin, pa vonesë, për çdo fakt ose dyshim që është sjellë në vëmendjen e tyre mbi një parregullsi për lidhjen dhe zbatimin e kontratave dhe marrëveshjeve të grantit, të përfunduara në lidhje me zbatimin e instrumenteve të përmendura në këtë Marrëveshje.

III. Masat administrative dhe gjobat

Pa cenuar zbatimin e ligjit penal të Shqipërisë, masat administrative dhe gjobat mund të vendosen nga Komisioni në përputhje me rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian.

IV. Rikuperimi

Vendimet e marra nga Komisioni, brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje, që caktojnë një detyrim financiar ndaj personave të ndryshëm nga shtetet, do të jenë të zbatueshme në Shqipëri. Zbatueshmëria do të drejtohet nga rregullat e procedurës civile në fuqi, në shtetin në territorin e të cilit është kryer. Urdhri i zbatimit i bashkëlidhet vendimit, pa formalitet tjetër, përveç verifikimit të

autenticitetit të vendimit, nga autoriteti i brendshëm që qeveria e Shqipërisë cakton për këtë qëllim dhe ia bën të ditur Komisionit. Kur këto formalitete të kenë përfunduar me kërkesë të Komisionit, ky i fundit mund të vazhdojë me ekzekutimin në përputhje me ligjin e brendshëm, duke e sjellë çështjen drejtpërdrejt tek autoriteti kompetent. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian.

Vendimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian sipas një dispozite arbitrazhi në një kontratë brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje, do të jenë të zbatueshme më të njëjtat kushte.

V. Komunikimi i drejtpërdrejtë [opsional]

Komisioni do të komunikojë drejtpërdrejt me pjesëmarrësit dhe kontraktuesit në [emri i programit] të themeluar në [emri i vendit]. Ata mund t'i paraqesin drejtpërdrejt Komisionit informacionin dhe dokumentacionin që janë të nevojshëm për t'u paraqitur në bazë të instrumenteve të përmendura në këtë Marrëveshje dhe të kontratave dhe marrëveshjeve të granteve të lidhura për zbatimin e tyre.

LIGJ

Nr. 76/2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 10 107, DATË 30.3.2009, “PËR KUJDESHIN SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Titulli i kreut VII ndryshohet si më poshtë:



“KREU VII PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË DHE EDUKIMI I VAZHDESHËM PROFESIONAL”.

Neni 2

Në nenin 33 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë krijon program të detyrueshëm për edukimin e vazhdueshëm profesional, i quajtur “Programi i certifikimit për profesionistët e shëndetësisë”. Programi i certifikimit është sistem i bazuar në cikle periodike, brenda të cilave profesionistët duhet të mbledhin një numër të caktuar kreditesh të edukimit të vazhdueshëm profesional, bazuar në procedurat, kriteret dhe standardet e miratuara nga Këshilli i Ministrave. Certifikimi është procesi që profesionisti i shëndetësisë përfundon me përmbushjen e kriterëve të secilit cikël të programit të certifikimit dhe lidhet me ecjen në karrierë të profesionistit të shëndetësisë.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Punësimi ose kontratat në institucionet shëndetësore pezullohen, nëse profesionisti i shëndetësisë nuk merr asnjë kredit të edukimit të vazhdueshëm. Rifitimi i së drejtës për punësim ose kontrata me institucionet shëndetësore bëhet pasi profesionisti t’i jetë nënshtruar provimit të certifikimit.

Nëse profesionisti i shëndetësisë mbledh kredite të edukimit të vazhdueshëm, por më pak se limiti i kërkuar, ai duhet t’i nënshtrohet provimit të certifikimit brenda gjashtë muajve nga data e njohimit. Nëse dështon në provim, punësimi ose kontratat në institucionet shëndetësore pezullohen. Rifitimi i së drejtës për punësim ose kontrata me institucionet shëndetësore bëhet pasi profesionisti të ketë kaluar me sukses provimin e certifikimit.

Institucionet publike të kujdesit shëndetësor janë të detyruara të hartojnë dhe të zbatojnë programe të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e tyre.”.

Neni 3

Pas nenit 33 shtohen nenet 33/1 dhe 33/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 33/1

Sigurimi i cilësisë së aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm - akreditimi

1. Akreditimi është procesi i miratimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm ose/dhe i ofruesit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, bazuar në procedurat, standardet dhe kriteret e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Ofrues të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm janë të gjitha strukturat publike ose private, akademike ose joakademike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, të huaja dhe të vendit, që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në organizimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm në fushën e shëndetësisë, sipas kriterëve të miratuara.

3. Ofruesit e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm janë të detyruar të sigurojnë cilësinë e aktiviteteve që zhvillojnë, përmes respektimit të kriterëve të cilësisë e akreditimit, dhe standardet e edukimit të vazhdueshëm profesional.

4. Kriteret, standardet dhe procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, si dhe të ofruesve të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 33/2

Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë funksionon Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, me këtë përbërje:

a) përfaqësues nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim;

b) përfaqësues nga Fondit i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;

c) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;

ç) përfaqësues nga Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore;

d) përfaqësues nga Urdhri i Mjekëve;

dh) përfaqësues nga Urdhri i Infermierit;

e) përfaqësues nga Urdhri i Farmacistëve;

ë) përfaqësues nga Urdhri i Stomatologut.

Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm është organi më i lartë vendimmarrës në sistemin e certifikimit dhe ricertifikimit të profesionistëve të shëndetësisë dhe të akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm. Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm



mblidhet jo më pak se katër herë në vit dhe, për raste të veçanta, kur është e nevojshme, kryetari mund ta mbledhë atë edhe më shpesh. Mbledhjet e bordit janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimmarrja në Bordin e Edukimit të Vazhdueshëm bëhet me shumicë të thjeshtë.

2. Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm kryen këto funksione kryesore:

a) harton kriteret, standardet e procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm dhe të ofruesve të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm, si dhe kriteret e procedurat e procesit të certifikimit dhe/ose ricertifikimit të profesionistëve të shëndetësisë;

b) miraton tarifat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm;

c) miraton listën e ekspertëve të pavarur për secilën fushë ekspertize, të cilët do të përfshihen në vlerësimin e jashtëm të aktiviteteve, si pjesë e procesit të akreditimit, dhe masën e pagesës së tyre, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) shqyrton ankesat e bëra nga profesionistët e shëndetësisë për procedurat e njohjes dhe regjistrimit të krediteve përkatëse;

d) shqyrton ankesat e bëra nga ofruesit e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm për procesin e vlerësimit të jashtëm, të cilat nuk janë zgjidhur nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim;

dh) ndërmerr masat e nevojshme për realizimin e provimit të ricertifikimit për të gjithë profesionistët e shëndetësisë që nuk përmbushin kërkesat e programit të certifikimit;

e) monitoron zbatimin e programit të certifikimit për të siguruar përmbushjen e detyrave të institucioneve përgjegjëse.

3. Anëtarët e Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm shpërblehen sipas legjislacionit në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të bordeve, këshillave ose komisioneve.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9188, datë 27.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Faqe | 6762

LIGJ
Nr. 77/2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË LIGJIN NR. 125/2013 “PËR
KONCESIONET DHE PARTNERITETIN
PUBLIK PRIVAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, pika 12 riformulohet si më poshtë:
“12. “Subjekti për qëllime të veçanta (SPV)” është:

a) një person juridik privat, me seli në Republikën e Shqipërisë, i krijuar me kërkesë të autoritetit kontraktues nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, me të cilin lidhet kontrata;

b) një formë e partneritetit publik privat, për krijimin e një entiteti të përbashkët të partnerit publik dhe atij privat, që kryen punë apo shërbime në bazë të një kontrate koncesioni/partneriteti publik privat dhe ku partneri privat, përveç kontributit në kapital apo asete, kontribuon edhe me pjesëmarrje aktive në menaxhimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat. Kontributet e thjeshta të kapitalit nga investitorët privatë në kompanitë shtetërore nuk përbëjnë SPV.”.

Neni 2

Në nenin 4, pika 1, pas shkronjës “m” shtohet shkronja “n” me këtë përmbajtje:
“n) bujqësi.”.

Neni 3

Në nenin 5, pika 1, shkronja “i” riformulohet si më poshtë:
“i) për ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimeve



të energjisë së rinovueshme, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2013 “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, përveç hidrocentraleve me kapacitet të instaluar mbi 2 MW.”.

Neni 4

Neni 7, “Koncesionet për hidrocentralet”, shfuqizohet.

Neni 5

Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 9/1

Ministria përgjegjëse për ekonominë

Ministria përgjegjëse për ekonominë është institucioni përgjegjës, i cili orienton dhe harmonizon veprimtaritë për zhvillimin e koncesioneve /partneriteteve publike private.”.

Neni 6

Neni 11 riformulohet si më poshtë:

“Neni 11

Agjencia e Prokurimit Publik

Agjencia e Prokurimit Publik kryen detyrat e mëposhtme:

a) monitoron respektimin e procedurave konkurruese të koncesioneve /partneriteteve publike private, sipas legjislacionit për prokurimet publike, pas nënshkrimit të kontratës dhe, në rast të shkeljeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, vendos gjoba ose propozon marrjen e masave administrative;

b) përfshihet një operator ekonomik, sipas dispozitave të ligjit të prokurimit publik, nga pjesëmarrja në procedurat e koncesioneve /partneriteteve publike private;

c) kryen publikimin e dokumenteve standarde të tenderit.

Neni 7

Paragrafi i parë i nenit 12 numërohet “1” dhe pas tij shtohen pikat 2,3,4 me këtë përmbajtje:

“2. Njësia e Trajtimit të Koncesioneve /Partneriteteve Publike Private asiston autoritetet kontraktore me qëllim:

a) përgatitjen e studimit të fizibilitetit;

b) përgatitjen e dokumenteve të procedurës konkurruese dhe kriterëve të vlerësimit;

c) vlerësimin e propozimeve dhe përcaktimin e ofertuesit më të mirë;

ç) kryerjen e negociemeve dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit;

d) monitorimin e kontratave të koncesionit.

3. Njësia e Trajtimit të Koncesioneve / Partneriteteve Publike Private gjithashtu:

a) propozon pranë ministrit përgjegjës për ekonominë ndryshimin e legjislacionit në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, si dhe udhëzimet për zbatimin e dispozitave të këtij ligji;

b) monitoron, analizon dhe studion tendencat aktuale europiane dhe globale të njohurive dhe përvojës në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private;

c) bashkëpunon me APP-në për hartimin dhe publikimin e dokumenteve standarde të koncesionit/partneritetit publik privat.

4. Mënyra e organizmit dhe funksionimit të Njesisë së Trajtimit të Koncesioneve /Partneriteteve Publike Private përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 8

Në nenin 13 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 2 riformulohet si më poshtë:

“2. Autoritetet kontraktuese janë:

a) ministritë e linjës;

b) njësitë e qeverisjes vendore.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Kur objekt i kontratës së koncesionit / partneritetit publik privat është fushë e veprimtarisë së më shumë se një autoriteti kontraktor, Këshilli i Ministrave me vendim përcakton autoritetin kontraktor/autoritetet kontraktore, sipas rastit.”.

Neni 9

Në nenin 14, pika 2 riformulohet si më poshtë:

“2. Regjistri i koncesionit/partneritetit publik privat krijohet dhe mbahet nga Njësia e Trajtimit të Koncesioneve/Partneriteteve Publike Private, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.”.

Neni 10

Titulli i kreut II ndryshohet si më poshtë:



“VEPRIMET PËR DHËNIEN E KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT”.

Neni 11

Neni 16 riformulohet si më poshtë:

“Neni 16

Veprimet për dhënie e koncesionit/partneritetit publik privat

1. Veprime për dhënie e një koncesioni /partneritetit publik privat quhen të gjitha aktivitetet e ndërmarra që nga identifikimi i projekteve deri në fazën e monitorimit të kontratës në zbatim të këtij ligji.

2. Autoriteti kontraktues mund të angazhojë këshilltarë të jashtëm për të siguruar mbështetjen e ekspertëve në përgatitjen dhe dhënie e projekteve të koncesionit/partneritetit publik privat.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregulla më të hollësishme në zbatim të pikës 1 të këtij neni.”.

Neni 12

Në nenin 17, pika 3 shfuqizohet.

Neni 13

Neni 18 riformulohet si më poshtë:

“Neni 18

Komisioni i koncesionit/partneritetit publik privat

1. Për shqyrtimin dhe dhënie e koncesionit /partneritetit publik privat, autoriteti kontraktues, në koordinim me Njësinë e Trajtimit të Koncesioneve/Partneriteteve Publike Private, krijon komisionin e koncesionit/partneritetit publik privat.

2. Anëtarët e komisionit duhet të jenë me profesion jurist, ekonomist, profesion teknik dhe profesione nga fusha të tjera përkatëse, në varësi të objektit dhe karakteristikave të koncesionit /partneritetit publik privat.

3. Numri i anëtarëve në komisionin e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është tek, por jo më pak se 5 anëtarë, nga të cilët jo më pak se 2 janë nga Njësia e Trajtimit të Koncesioneve /Partneriteteve Publike Private. Për projekte koncesioni/partneriteti publik privat, objekti i të cilave është i ngjashëm në natyrë, mund të krijohet një komision i vetëm.

4. Anëtarët e komisionit të koncesionit /partneritetit publik privat nuk duhet të kenë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë privat në asnjë prej aktiviteteve që përbëjnë konflikt interesi, në përmbushje të detyrave si anëtarë të këtij komisioni, gjë të cilën ata e konfirmojnë me nënshkrimin e një deklarate që garanton se nuk kanë konflikt interesi, sipas parashikimeve në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

5. Komisioni i koncesionit/partneritetit publik privat kryen detyrat e mëposhtme:

a) harton studimin e fizibilitetit për koncesionin /partneritetin publik privat, përcakton procedurën e zbatueshme për dhënie e koncesionit /partneritetit publik privat dhe harton dokumentacionin e tenderit;

b) shqyrton dhe vlerëson ofertat e pranuar dhe/ose kërkesat për pjesëmarrje, që janë dorëzuar;

c) formulon propozimin e përzgjedhjes së ofertës së suksesshme ose propozimin e vendimit për ndërprerjen e procedurës së prokurimit, si dhe një shpjegim të tyre;

ç) kryen të gjitha aktivitetet e tjera që kërkohen për zbatimin e procedurës së koncesionit /partneritetit publik privat, në përputhje me rregulloret në fuqi.

6. Komisioni i dhënies së koncesionit /partneritetit publik privat mban procesverbale për pasqyrimin e punës së tij, të cilat duhet të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit.”.

Neni 14

Në nenin 19, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Studimi i fizibilitetit për koncesionin /partneritetin publik privat hartohet nga komisioni i dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat brenda 60 ditëve pune nga krijimi i këtij komisioni. Ky afat mund të shtyhet për shkaqe të kompleksitetit të projektit me jo më shumë se 30 ditë pune.”.

Neni 15

Në nenin 21, pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Dokumentet e tenderit hartohen dhe trajtohen nga autoriteti kontraktues, në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij ligji.”.



Neni 16

Neni 22 riformulohet si më poshtë:

“Neni 22

Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private

1. Procedura për dhënien e koncesioneve /partneriteteve publike private fillon me publikimin e njoftimit të kontratës dhe përfundon me publikimin e njoftimit të fituesit për dhënien e kontratës ose me vendimin për ndërprerjen e procedurës së dhënies së kontratës.

2. Procedura për dhënien e koncesioneve /partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj.

3. Në dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurën e hapur, procedurën e kufizuar ose procedurën me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Për të vazhduar procesin e përzgjedhjes së fituesit duhet të pranohet së paku një ofertë e vlefshme.

4. Kur jepen koncesione të punëve publike, afati për dorëzimin e ofertave është jo më pak se 30 ditë nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.”

Neni 17

Në nenin 23 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Kriteret e vlerësimit për dhënien e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat.”

2. Pikat 1 dhe 2 riformulohen si më poshtë:

“1. Kriter vlerësimi për dhënien e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat është oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret e ndryshme, të lidhura me objektin e koncesionit /partneritetit publik privat në fjalë, që përfshijnë cilësinë, meritat teknike, karakteristikat estetike, funksionale e të mjedisit, kostot e drejtimit, kosto të efektivitetit, ofrimin e shërbimeve pas dorëzimit të produkteve dhe asistencën teknike, datën e dorëzimit dhe periudhën e dërgesës ose periudhën e përfundimit të punimeve, çmimin e shërbimit për përfituesit fundorë, shumën e tarifës së koncesionit.

2. Komisioni i dhënies së koncesionit specifikon në dokumentet e tenderit dhe në njoftimin e kontratës koeficientët relativë, që ai i jep secilit prej

kritereve të zgjedhura për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme. Këta koeficientë mund të shprehen duke parashikuar një gamë me një shtrirje të përshtatshme maksimale. Kur kjo nuk është e mundur, për shkak të arsyeve të justifikuara, autoriteti kontraktues tregon në njoftimin e kontratës kriteret, sipas rendit zbritës të rëndësisë.”

3. Pika 3 shfuqizohet.

Neni 18

Në nenin 24, pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. Palët e interesuara për procedurën konkurruese kanë të drejtë të kërkojnë ndryshimin ose korrigjimin e dokumenteve standarde të procedurës konkurruese. Kjo kërkesë duhet depozituar brenda 10 ditëve, nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të kontratës. Në rast se dokumentet e procedurës konkurruese ndryshohen ose korrigjohen, afati i fundit për dorëzimin e ofertave mund të shtyhet, në përputhje me rrethanat, por jo më shumë se 10 ditë.”

Neni 19

Në nenin 25 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 riformulohet si më poshtë:

“2. Nëse propozimi i pakërkuar konsiderohet i pranueshëm, pas vlerësimit paraprak, autoriteti kontraktues mund të ndërmarrë veprimet për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat. Nuk do të pranohen propozimet e pakërkua, të shoqëruara me studim në formë minimale.”

2. Pikat 3, 4 dhe 5 shfuqizohen.

3. Pikat 6 dhe 7 riformulohen si më poshtë:

“6. Propozuesit i jepet një bonus për rezultatin teknik dhe/ose financiar të arritur gjatë procedurës konkurruese deri në një maksimum 10 për qind të pikëve totale të garës.

7. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat për vlerësimin e pranueshmërisë, përmbajtjen dhe trajtimin e propozimeve të pakërkua.”

Neni 20

Neni 43 riformulohet si më poshtë:

“Neni 43

Procedura e rishikimit administrativ

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë konkurruese dhe kur është



dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor të koncesionit/partneritetit publik privat, për të cilin pretendon se është marrë në kundërshtim me këtë ligj, ka të drejtë të ankimojë në Komisionin e Prokurimit Publik.

2. Në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës konkurruese, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankimojnë brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.

3. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankimojnë brenda 10 ditëve nga dita e nesërme, kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhej të ishte vënë në dijeni.

4. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimsht për dijeni edhe autoritetit kontraktor. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës konkurruese deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi nga KPP-ja.

5. Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me shkrim, sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat ai mendon se mbështesin ankimin e tij.

6. Komisioni i Prokurimit Publik përgjigjet me shkrim brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Kur për shqyrtimin e ankesës kërkohet informacion nga autoriteti kontraktor, KPP-ja përgjigjet me shkrim jo më vonë se 20 ditë.

7. Procedura e rishikimit administrativ dhe vendimmarrja e KPP-së, në përfundim të shqyrtimit të ankesës, bëhen në përputhje me parashikimet përkatëse në legjislacionin e prokurimit publik.

8. Ndaj vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, ankimesi ka të drejtë të ankimojë në gjykatën përkatëse që shqyrton mosmarrëveshjet administrative. Ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurat konkurruese, lidhjen e kontratës apo ekzekutimin e detyrimeve mes palëve.”

Neni 21

Në nenin 46, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet autoritetit

kontraktues dhe koncesionarit /partnerit privat zgjidhet përmes mekanizmave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të pranuar nga palët në kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat, duke përfshirë edhe procedurat e arbitrazhit ndërkombëtar. Në çdo rast, ligji i zbatueshëm është ligji shqiptar në fuqi.”

Neni 22

Neni 51 shfuqizohet.

Neni 23

Zbatimi i dispozitave

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për veprimet dhe procedurat për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, të filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 24

Këshilli i Ministrave, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore, të përcaktuara në nenet 7, pika 4; 11, pika 3; dhe 19, pika 4, të këtij ligji.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9189, datë 27.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 78/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË SHËRBIMIT KËSHILLIMOR FINANCIAR NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË, DHE KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e shërbimit këshillimor financiar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë, dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9190, datë 27.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

NUMRI I PROJEKTTIT 600511

**MARRËVESHJE E SHËRBIMIT
KËSHILLIMOR FINANCIAR
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
KORPORATËS FINANCIARE
NDËRKOMBËTARE
datë 5 shkurt 2015**

Marrëveshje e datës 5 shkurt 2015, ndërmjet:

1. Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë (Klienti); dhe

2. Korporatës Financiare Ndërkombëtare, një organizatë ndërkombëtare e krijuar në bazë të neneve të Marrëveshjes ndërmjet vendeve të saj anëtare, përfshirë Republikën e Shqipërisë (IFC).

Duke marrë në konsideratë se:

A. Klienti ka përgjegjësinë kryesore për sektorin shëndetësor dhe dëshiron të zhvillojë një rrjet laboratorësh me pjesëmarrjen e sektorit publik.

B. Klienti dëshiron të paraqesë pjesëmarrjen e sektorit privat për shërbimet laboratorike dhe të përmirësojë eficiencën, duke transferuar menaxhimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e laboratorëve (objekteve) të një apo më shumë

investitorë privatë me përvojë në menaxhimin eficient, funksionimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të ngjashme në sektorin e shërbimeve laboratorike dhe që do të zbatojë një plan modernizimi të godinës dhe pajisjeve të objekteve/laboratorëve (Projekti).

C. IFC-ja është një institucion ndërkombëtar financiar, anëtar i të cilit është Shqipëria, dhe me përvojë të njohur në fushën e privatizimit dhe ristrukturimit të shoqërive dhe shërbimeve publike në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë sektorin e shëndetësisë.

D. Klienti ka ngarkuar IFC-në, dhe IFC-ja ka pranuar këtë detyrë si këshilltar kryesor ekskluziv për të ndihmuar në fazat e ndryshme të rishikimit, strukturimit dhe zbatimit të Projektit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

E. Klienti pranon që emërimi i përmendur në paragrafin pararendës është kryer me mirëkuptimin dhe vullnetin e tij dhe që në të ardhmen IFC-ja dhe anëtarët e tjerë të Grupit të Bankës Botërore (p.sh. Agjencia Multilaterale e Garantimit të Investimeve, MIGA) mund të përfshihen më tej në këtë Projekt, përfshirë sigurimin e financimit apo instrumente të tjera për fituesin e tenderit, pas shpalljes së fituesit të Projektit. Proceset dhe procedurat e Grupit të Bankës Botërore në lidhje me menaxhimin e konflikteve të interesit të biznesit, do të zbatohen për çdo konflikt që mund të lindë në lidhje me rolin shumëplanësh që entet e Grupit të Bankës Botërore mund të ndërmarrin për këtë Projekt.

1. Shërbimet

a) IFC-ja do t'i sigurojë Klientit shërbimet e parashtruara në aneksin 1 (Shërbimet) për të ndihmuar Klientin të arrijë rezultatet e mëposhtme:

Futjen/prezantimin e pjesëmarrjes së sektorit privat në ofrimin e shërbimeve laboratorike publike që do të financojë, rehabilitojë dhe funksionojë/operojë një apo më shumë rrjete të laboratorëve publikë, të vendosur në spitalet universitare dhe spitalet rajonale, siç mund të jetë rasti.

b) Shërbimet do të sigurohen nga IFC-ja nëpërmjet stafit të IFC-së dhe konsulentëve të jashtëm të kontraktuar nga IFC-ja dhe bazuar në rregulloren e IFC-së për prokurimet (Konsulentët e kontraktuar nga IFC-ja), të specializuar



në fusha të ndryshme ekspertize. Për këtë qëllim, IFC-ja do të krijojë një ose më shumë ekipe të Projektit nga stafi i IFC-së, stafi i Grupit të Bankës Botërore dhe nga Konsulentët e Kontraktuar nga IFC-ja, sipas nevojave në lidhje me fazat përkatëse të Shërbimit.

IFC-ja do t'i sigurojë Klientit shërbimet e parashtruara në aneksin 2 (Shërbimet) për të ndihmuar Klientin në strukturimin e Projektit, përgatitjen dhe realizimin e një procesi konkurrues, të hapur dhe transparent përzgjedhjeje, për të tërhequr partnerë privatë optimalë të sektorit për Partneritetin Publik Privat (PPP-në).

c) Klienti i siguron IFC-së në kohë të gjithë informacionin që mund të ndikojë në ecurinë e Shërbimeve, informon IFC-në për çdo zhvillim që lidhet me Projektin dhe udhëzon çdo person që kërkon informacion rreth Projektit të kontaktojë IFC-në, nëpërmjet përfaqësuesit të IFC-së (siç përshkruhet në seksionin 3 më poshtë). Në këtë aspekt, Klienti konfirmon që nuk ka pasur kërkesa të mëparshme nga asnjë person në lidhje me Projektin, për të cilat nuk ka informuar IFC-në, përfshirë ndonjë propozim të pakërkuar në lidhje me Projektin.

d) Klienti bën të gjitha përpjekjet e nevojshme që t'i japë mundësi IFC-së, stafit të saj dhe Konsulentëve të Kontraktuar të IFC-së të kryejnë Shërbimet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, pa kufizim:

i) do t'i sigurojë IFC-së të gjithë informacionin për Klientin (që mund të çmohet të ketë lidhje me Projektin) dhe Projektin që IFC-ja mund të konsiderojë të nevojshëm;

ii) do të lejojë përfaqësuesit e IFC-së, përfshirë stafin e IFC-së dhe Konsulentët e Kontraktuar nga IFC-ja, të vizitojnë dhe të inspektojnë vendndodhjen e Projektit dhe çdo ambient tjetër, përfshirë objektet ekzistuese mjekësore, të ketë akses te pasqyrat dhe regjistrat financiarë dhe të kenë mundësi për të kontaktuar punonjësit, menaxherët, revizorët dhe agjentët;

iii) do t'i sigurojë IFC-së, stafit të saj dhe Konsulentëve të kontraktuar nga IFC-ja, pa kosto, hapësirë për zyrë të të gjitha vendndodhjet përkatëse ku ndodhen objektet së bashku me shërbim sekretarie, logjistike dhe shërbime mbështetëse;

iv) do të njoftojë menjëherë IFC-në për çdo ndryshim të propozuar në lidhje me natyrën ose objektin e Projektit, ose të biznesit, ose operacioneve të Klientit, dhe për çdo ngjarje apo gjendje që kanë ose mund të pritet të kenë një ndikim material në kryerjen e shërbimeve;

v) do të udhëzojë çdo kërkesë/pyetje rreth Projektit të përfaqësuesit të IFC-së;

vi) do të zgjedhë një ose më shumë objekte për Projektin, ose në bazë të objekteve mjekësore ekzistuese, ose në vende me akses dhe infrastrukturë të nevojshme (transport, elektricitet dhe ujë);

vii) Klienti ndërmeret alokimin e pronësisë së tokës nga autoritetet lokale, pa ia vënë në ngarkim pagesën investitorit, nëse kjo është e nevojshme;

viii) nëse kërkohet një studim fizibiliteti, ta kryejë atë me shpenzimet e Klientit;

ix) menjëherë t'i paraqesë/përcjellë IFC-së informacione të tjera sipas kërkesës kërkesë kohë pas kohe të IFC-së rreth Klientit, asetëve të tij, objekteve dhe Projektit.

e) Me kërkesë të Klientit dhe pas gjykimit të IFC-së, IFC-ja mund të bjerë dakord: i) të ndihmojë Klientin në krijimin e një faqeje interneti të sigurt dhe të përshtatshme për Projektin dhe një shërbim/dhomë me të dhëna *on line (data room)* për investitorët e mundshëm nëpërmjet faqes së internetit për të lehtësuar shërbimet; dhe ii) të këshillojë Klientin në lidhje me një palë të tretë të përshtatshme për hapjen e faqes së internetit, si dhe për kushtet dhe kërkesat e duhura për këtë faqe, e cila është përgjegjësia vetëm e Klientit. Nëse IFC-ja bie dakord që të ofrojë këtë ndihmë, IFC-ja nuk përgjigjet për ndonjë humbje, dëmtim ose detyrime që Klienti ose çdo palë e tretë mund të pësojë ose shkaktojë si pasojë e përdorimit të këtij shërbimi, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ndonjë veprim ose mosveprim të ofruesit të shërbimit të palës së tretë për hapjen e faqes së internetit. Faqja e internetit e Projektit nuk përfshin ndonjë mjet për të ofruar apo shitur obligacionet ose të shpallë apo ofrojë ndonjë mundësi investimi, pa miratimin paraprak të IFC-së dhe në çdo rast në bazë të atyre opinionëve ligjore që IFC-ja mund t'i konsiderojë të arsyeshme.



f) Klienti pranon se IFC-ja i ka dhënë Klientit një kopje të Kuadrit Mbështetës të IFC-së, i cili përbëhet nga Politika mbi Mjedisin dhe Qëndrueshmërinë Sociale, Standarde të Performancës dhe Qasjen në Politikën e Informacionit, e cila është, gjithashtu, e disponueshme në faqen e internetit: www.ifc.org/sustainability. Klienti pranon dhe bie dakord që të gjitha veprimet nga ana e IFC-së të udhëhiqen nga ky kuadër, dhe se në përputhje me rrethanat, në kryerjen e Shërbimeve IFC-ja do të këshillojë Klientin në përputhshmëri me këtë kuadër. Në hartimin dhe kryerjen e transaksionit, Klienti do t'i kushtojë vëmendjen e duhur Standardeve të Performancës apo standardeve të tjera të krahasueshme, deri në atë masë që ato të mos jenë në kundërshtim me ligjet apo rregulloret në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

g) Nëse Klienti i kërkon IFC-së t'i japë mbështetje shtesë ose të vazhdueshme në lidhje me zbatimin apo zhvillimin e Projektit, pas datës së mbylljes së Transaksionit, d.m.th., data në të cilën është nënshkruar marrëveshja për dhënien e këtij transaksioni, IFC-ja mund, me të drejta të plota e pa asnjë detyrim, të bjerë dakord të ofrojë këtë shërbim shtesë, siç mund të bihet dakord midis palëve, në varësi të kushteve dhe modaliteteve, duke përfshirë, pa kufizim, shpërbimin shtesë që është reciprokisht i pranueshëm nga palët nënshkruese.

2. Programi i punës dhe afatet

a) Në bazë të kushteve të parashtruara këtu, shërbimet do të kryhen nga IFC-ja në përputhje me programin e punës dhe kohëzgjatjen për fazat e Projektit, të përcaktuara në aneksin 2.

b) Ndërsa IFC-ja merr përsipër të mobilizojë të gjitha mjetet e arsyeshme të mundshme për të kryer shërbimet në kohën e duhur, programi i punës dhe përcaktimi i afateve në aneksin 2, janë përgatitur në mirëbesim, në përputhje me kërkesat për çdo fazë të Projektit, në bazë të informacionit aktual në dispozicion të IFC-së dhe të parashtruar me përafërsi, duke marrë parasysh që:

i) Konsulentët e Klientit do të kryejnë të gjitha detyrat e tyre përkatëse në mënyrë të kënaqshme dhe brenda afatit kohor; dhe

ii) Në çdo kohë Klienti do të sigurojë në kohën e duhur informacionin, duke marrë

vendime dhe duke siguruar mbështetjen e nevojshme, siç është parashikuar këtu dhe siç kërkohet herë pas here nga IFC-ja.

c) Për më tepër, programi i punës dhe afatet e parashtruara në aneksin 2, mund të ndikohen nga vendimet dhe orientimet strategjike që Klienti do të duhet të ndërmarrë herë pas here gjatë ose në fund të secilës fazë dhe që mund të përcaktojnë kursin e ecurisë së fazës së mëtejshme.

3. Përfaqësuesit e Palëve dhe njoftimet

a) Klienti përzgjedh dhe emëron një person i cili do të veprojë si përfaqësues i Klientit (Përfaqësuesi i Klientit). Emri i Përfaqësuesit të Klientit i njoftohet me shkrim IFC-së në ose para datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes (ky kusht përcaktohet në seksionin 16 më poshtë). Përfaqësuesi i Klientit është i nivelit dhe përgjegjësishë, të tillë dhe ka aksesin e duhur te vendimmarrësit që të ushtrojë kompetencë dhe autoritet të përgjithshëm për të urdhëruar dhe koordinuar në emër të Klientit, përfshirjen e çdo autoriteti dhe pale të tretë në realizimin e Projektit, si dhe në marrjen e vendimeve sipas kësaj Marrëveshjeje në kohën e duhur.

b) Përfaqësuesi i Klientit është plotësisht i autorizuar dhe i jepet autoritet i plotë për të vepruar në emër të Klientit për të gjitha çështjet e parashtruara në këtë Marrëveshje dhe për të gjitha synimet dhe qëllimet pa kufizim, përkatësisht:

i) të gjitha raportet, rekomandimet dhe komunikimet e tjera të çdo lloji të dhëna nga IFC-ja te Përfaqësuesi i Klientit, konsiderohen që i janë dorëzuar Klientit sipas kësaj Marrëveshjeje;

ii) të gjitha udhëzimet, miratimet, heqjet dorë, pëlqimet, vendimet dhe komunikimet që merren nga IFC-ja prej Përfaqësuesit të Klientit, konsiderohen si të dorëzuara ose të bëra nga, dhe të marra nga Klienti sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

iii) Përfaqësuesi i Klientit do të realizojë në çdo kohë koordinimin dhe bashkëpunimin e duhur dhe efikas dhe do të sigurojë mobilizimin e të gjitha burimeve të nevojshme, për t'i dhënë mundësi IFC-së që të kryejë detyrat e saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

c) IFC-ja cakton z. Georgi Petrov, menaxher rajonal (menaxher rajonal i kësaj linje biznesi) si përfaqësues të saj (Përfaqësuesi i IFC-së), me kompetencë dhe autoritet të plotë, për të vepruar



në emër të IFC-së për të gjitha çështjet që parashtrihen në këtë Marrëveshje dhe për të gjitha synimet dhe qëllimet pa kufizim.

d) Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër, që do të bëhet në bazë të kësaj Marrëveshje, do të jetë me shkrim dhe do të konsiderohet që është dorëzuar kur dërgohen me dorë, me postë, me shërbim të veçantë korrier ose me faks, Palës së cilës i është dorëzuar në adresën e përcaktuar më poshtë ose në adresë, të tillë siç përcaktohet nga Pala, me njoftim Palës që jep këtë njoftim, kërkesë ose komunikim.

Për Klientin:

Adresa për komunikim:

Ministria e Shëndetësisë

Bulevardi “Bajram Curri”, nr. 1

Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2376 178

Në vëmendje të: Znj. Milva Ekonomi

Zëvendësministër i Shëndetësisë

Për IFC-në:

Adresa për komunikim:

International Finance Corporation

Bulevar Kralja Aleksandra, 86

11000 Belgrade, Serbia

Tel: (+ 381 11) 30 23 750

Faks: (+ 381 11) 30 23 740

Në vëmendje të: Mr. Georgi Petrov

Menaxher rajonal

Shërbimet Këshillimore të IFC-së për Partneritetin Publik Privat

Departamenti i Evropës dhe Azisë Qendrore

e) Si Klienti, ashtu edhe IFC-ja mund të ndryshojnë përfaqësuesit e tyre duke njoftuar me shkrim Palët.

4. Pagesa

IFC-ja merr pagesat si më poshtë:

a) Një pagesë fikse prej gjashtëdhjetë e katër mijë dollarësh amerikanë (\$64.000) për shërbimet e përcaktuara në aneksin 1, që do të paguhet në dy këste, secili brenda 15 ditëve kalendarike nga ngjarja e renditur në tabelën e mëposhtme kundrejt këtij kësti:

Shuma e Ngjarja për të cilën bëhet Këstit pagesa

1. \$ 40,000 Data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje

2. \$ 24,000 Data e dorëzimit të Raportit të Strukturës së Transaksionit

Megjithatë, me kusht që, dhe pa cenuar të drejtat dhe mjetet ligjore ndaj IFC-së sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse një pjesë e shërbimeve mbetet e paplotësuar pas kalimit të 12 muajve pas datës kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi, Klienti do të paguajë një shumë totale parapagimi prej pesëmbëdhjetë mijë dollarësh amerikanë (\$15.000) në muaj, që fillon në muajin e 13 (trembëdhjetë) dhe përfundon jo më vonë se 18 (tetëmbëdhjetë) muaj ose përfundimi i kësaj Marrëveshjeje;

b) Një pagesë për suksesin e transaksionit, që nuk duhet të kalojë 2% të kapitalit kumulativ dhe shpenzimet operative mbi kohëzgjatjen e kontratës së PPP-së, siç parashikohet nga IFC-ja me dorëzimin e studimit të fizibilitetit për shërbimet e parashtruara në aneksin 1 brenda 15 ditëve kalendarike, pas datës së mbylljes së transaksionit, d.m.th. data në të cilën Marrëveshja parashikon nënshkrimin e transaksionit. Për qëllimin e këtij paragrafi, “transaksion” nënkupton çdo marrëveshje apo grup marrëveshjesh që parashikojnë investimin në para në dorë ose në natyrë nga çdo person (një investitor) në projekt, qoftë: A) në formën e blerjes ose regjistrimit të aksioneve të Klientit; ose B) blerjes së një pjese të konsiderueshme të asetëve të Projektit me anë të blerjes, qirasë ose ndryshe; ose C) marrjes përsipër të funksionimit dhe/ose menaxhimit të Projektit.

5. Kostot e transaksionit

Pavarësisht nga sa më sipër, pagesa dhe shpenzimet e përmendura në seksionin 4 më sipër, nuk përfshijnë pagesa dhe shpenzime që lidhen me zbatimin e Projektit, si për shembull, pa kufizim, kostot e vendosjes, kostot e reklamave, kostot e fushatave të opinionit publik, ku të gjitha do të jenë për llogari dhe do të paguhet (ose do të detyrohet të paguhet) nga Klienti sipas marrëveshjeve të drejtpërdrejta që duhet të bëhen ndërmjet Klientit dhe ofruesve përkatës të shërbimeve ose fondeve.

6. Pagesat

a) Të gjitha pagesat për IFC-në, sipas kësaj Marrëveshjeje, bëhen plotësisht kur të jenë të kërkueshme, në dollarë amerikanë në fonde menjëherë të disponueshme, pa asnjë zbritje për



taksat, detyrimet, tarifat ose mbajtje të tjera bankare (të cilat duhet të përballohen nga Klienti) në llogarinë e IFC-së:

International Finance Corporation
Account No. 2000192003476

WELLS FARGO BANK, N.A.
375, PARK AVENUE: NEW YORK, NY
10152
UNITED STATES OF AMERICA

ose në një bankë tjetër në një vend që IFC-ja mund të caktojë herë pas here.

b) Klienti do të garantojë që marrëveshjet, të cilat tregojnë transaksionin të parashikojnë në mënyrë të parevokueshme, në bazë të kushteve që i paraprijnë hyrjes në fuqi të transaksionit, për detyrimin e investitorit ose investitorëve që t'i paguajë direkt IFC-së, siç është përcaktuar në këtë Marrëveshje, pagesën e suksesit të transaksionit që i detyrohet IFC-së në përputhje me seksionin 4/b më sipër. Në rastin kur ofertuesi fitues, në mënyrë të parevokueshme nuk pranon të kryejë pagesën e suksesit të transaksionit ose nuk ia paguan atë IFC-së brenda 30 ditëve kalendarike, pas datës kur është i detyruar të bëjë pagesën, Klienti, në mënyrë të parevokueshme, pranon të bëjë pagesën e suksesit të transaksionit për IFC-në, siç është parashikuar në këtë Marrëveshje.

c) Nëse Klienti nuk bën pagesën në kohën e duhur, ai do të paguajë interesin në shumën e asaj pagese në normën prej 10% (dhjetë për qind) në vit, dhe ky interes llogaritet nga data kur duhet të bëhet pagesa përkatëse deri në datën kur bëhet pagesa aktuale (përpara dhe pas gjykimit).

7. Përfundimi i kontratës

a) Klienti, në çdo kohë kur e çmon të arsyeshme, mund të prishë këtë Marrëveshje duke i bërë një njoftim me shkrim IFC-së, të paktën 30 (tridhjetë) ditë para datës efektive të përfundimit dhe në bazë të dispozitave të paragrafit “d” të këtij seksioni 8, detyrimet e palëve do të përfundojnë menjëherë, përveç faktit që Klienti do të paguajë menjëherë të gjitha pagesat, kostot dhe shpenzimet e IFC-së dhe Konsulentëve të Kontraktuar nga IFC-ja, të llogaritura që nga data kur ka hyrë në fuqi përfundimi i kontratës, plus pjesët përkatëse të pagesave të ndryshme si më poshtë:

i) Nëse përfundimi nga Klienti ndodh para përmbushjes së shërbimeve të referuara në aneksin 1, faza 1, IFC-ja ka të drejtë të marrë të gjithë pagesën e përmendur në paragrafin “a” të seksionit 4 më sipër, dhe Klienti do të paguajë shumën e mbetur nga pjesa e papaguar; dhe

ii) Nëse përfundimi nga Klienti ndodh pasi IFC-ja të ketë përmbushur shërbimet e referuara në aneksin 1, faza 1, Klienti do t'i paguajë IFC-së një shumë totale të pagesës prej nëntëdhjetë mijë dollarësh amerikanë (\$ 90,000);

iii) Nëse përfundimi nga Klienti ndodh pasi është lançuar tenderi ose IFC-ja ka përmbushur shërbimet, referuar në aneksin 1 dhe ndërsa kontaktet me ndonjë nga investitorët potencialë, në lidhje me transaksionin janë në vazhdim, Klienti do t'i paguajë IFC-së pagesën e suksesit, referuar pikës “b”, seksionit 4 më sipër, sikur transaksioni të ishte përfunduar.

Megjithatë, me kusht që asnjë nga shumat e përmendura në nënparagrafët pararendës “i” deri “iii” nuk do të bëhen të kërkueshme, nëse mbyllja e kontratës nga Klienti shkaktohet si pasojë e mospërmbushjes së provuar nga IFC-ja të detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, përveçse si rezultat: A) i ndonjë prej rasteve të përmendura në seksionin 13 më poshtë, që vazhdon për një periudhë prej 6 muajsh ose një periudhë e tillë më e gjatë për të cilën mund të jetë rënë dakord reciprokisht nga palët; ose B) i një mospërmbushje e provuar korresponduese nga Klienti për të kryer detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) IFC-ja, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Klientit të paktën 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para datës së hyrjes në fuqi të përfundimit të Marrëveshjes, mund t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje nëse në çdo kohë, kur:

i) Klienti nuk kryen detyrimet, përfshirë, pa kufizim, mospagimin në kohë, mospagimin e informacionit të plotë dhe të saktë në kohën e duhur, ose nëse informacioni paraprak, i përcaktuar në aneksin 1, nuk është i saktë, në shkallën e njohur për Klientin në ndonjë aspekt material ose mosmarrjen e vendimeve ose masave për çështjet e përcaktuara në aneksin 2 brenda kohës përkatëse të përcaktuar në këto anekse;

ii) A) IFC-ja me arsye beson, pas konsultimeve me Klientin, që ndonjë përfaqësues



i Klientit është përfshirë në korrupsion, mashtrim, detyrim, marrëveshje të fshehtë, praktika penguese (Praktika sanksionuese) në lidhje me Projektin; ose B) Klienti hyn në ndonjë transaksion ose angazhohet në ndonjë aktivitet të ndaluar nga Këshilli i Sigurisë së Kombeve të Bashkuara apo komiteteve të tij, në pajtim me ndonjë rezolutë të kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara; ose C) si rezultat i ndonjë veprimi apo vendimi të Klientit, IFC-ja me arsye përcakton, pas konsultimit me Klientin, që nuk do të jetë më në gjendje të vazhdojë të këshillojë Klientin në lidhje me Projektin në një mënyrë që do të jetë materialisht në përputhje me Politikën Sociale dhe Mjedisore të IFC-së dhe Standardet e Performancës së IFC-së;

iii) IFC-ja përcakton që ajo nuk mund të realizojë detyrimet e saj për arsye që janë jashtë kontrollit të saj të drejtpërdrejtë; ose

iv) gjatë periudhës së konsultimit, referuar në aneksin 2, që ndan fundin e fazës së parë dhe fillimin e fazës së dytë, Klienti dhe IFC-ja nuk mund të bien dakord mbi realizueshmërinë e strukturës së transaksionit të dëshiruar nga Klienti dhe planin e zbatimit të Projektit;

në bazë të së cilës dhe në bazë të parashikimeve të paragrafit “d” të këtij seksioni 8, detyrimet e palëve do të përfundojnë menjëherë, përveç faktit që Klienti do të paguajë menjëherë të gjitha pagesat, kostot dhe shpenzimet e IFC-së dhe të konsulentëve të kontraktuar nga IFC-ja, të llogaritura që nga dita kur ka hyrë në fuqi përfundimi i Marrëveshjes, megjithatë me kusht që nëse përfundimi i marrëveshjes nga IFC-ja është shkaktuar nga mospërbushja e provuar nga Klienti, e kryerjes së detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur si rezultat: A) i çdo rasti të përmendur në seksionin 13 më poshtë, që vazhdon për një periudhë gjashtëmujore (6-mujore) ose një periudhë e tillë më e gjatë për të cilën palët mund të bien reciprokisht dakord; ose B) një pamundësi korresponduese nga IFC-ja për të përmbushur detyrimet e saj, Klienti përveç pagesave të pakryera dhe të shtuara, kostove dhe shpenzimeve, do t’i paguajë IFC-së pjesët përkatëse të pagesave të ndryshme, të përmendura në nënparagrafin “i” deri “iii”, të paragrafit pararendës “a” të këtij seksioni 8, sikur përfundimi të ishte bërë nga Klienti.

c) Përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe me shkrim, kjo Marrëveshje *ipso facto* do të përfundojë në ose pas 18 (tetëmbëdhjetë) muajve nga data efektive e kësaj Marrëveshjeje, në bazë të së cilës dhe në bazë të dispozitave të paragrafit “d” të këtij seksioni 8, detyrimet e palëve do të përfundojnë menjëherë, vetëm se Klienti do të paguajë menjëherë të gjitha pagesat, kostot dhe shpenzimet e IFC-së dhe konsulentëve të kontraktuar nga IFC-ja deri në datën efektive të përfundimit/ndërprerjes.

d) Pavarësisht nga ndonjë kundërshtim, këtu apo diku tjetër, dispozitat e seksioneve 6 (Pagesat), 12 (Forcë madhore), 13 (Raporte dhe dokumente; përdorimi i emrit, markës ose logos së IFC-së), 14 (Dorëheqjet dhe dëmshpërblimet) dhe 17 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) do t’i mbijetojnë përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, sido që të ndodhë.

8. Pezullimi

Palët, me miratim të ndërsjellë me shkrim, mund të vendosin të pezullojnë përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje për një periudhë kohe dhe mbi bazën e atyre termave dhe kushteve që ata do të përcaktojnë, megjithatë, me kusht që përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe, të gjitha afatet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, të cilat bien në dhe pas datës së pezullimit do të shtyhen në përputhje me zgjatjen aktuale të pezullimit.

9. Matja e ndikimit

a) Klienti pranon se në përputhje me procedurat e brendshme të IFC-së, performanca e Projektit duhet të vlerësohet duke përdorur indikatorët e zhvillimit dhe indikatorët tjerë të performancës. Në mënyrë që të sigurohet efektiviteti i këtij lloji vlerësimi, Klienti pranon, që në fillim të Projektit t’i sigurojë qasje IFC-së te dokumentet, siç do të jetë e nevojshme për të krijuar të dhënat që do të shërbejnë si baza mbi të cilat do të matet më vonë performanca e Projektit.

b) Klienti më tej merr përsipër t’i sigurojë IFC-së, për sa kohë IFC-ja do t’i ofrojë shërbime Klientit bazuar në këtë Marrëveshje, të dhëna të tilla dhe përgjigje pyetjeve që IFC-ja në mënyrë të arsyeshme kërkon, në mënyrë që të matet performanca e Projektit. Për më tepër, Klienti bie dakord që pasi shërbimet e IFC-së të përmendura në këtë Marrëveshje, të përfundojnë



dhe për një periudhë 10-vjeçare (dhjetëvjeçare) më pas, do të përpiqet në masën e arsyeshme të mundur Operatorët e Projektit, t'i japin IFC-së të dhëna të tilla dhe t'u përgjigjet pyetjeve të stafit të IFC-së, me qëllim vlerësimin e performancës së Projektit.

10. Autorizimet

Klienti bie dakord që të sigurojë dhe të mbajë në çdo kohë në fuqi ose të sigurojë arritjen dhe mbajtjen në fuqi të të gjitha autorizimeve (të përcaktuara si më poshtë), në kohën e duhur për përmbushjen efektive nga IFC-ja të shërbimeve, pagesën dhe remitancën e të gjitha pagesave për IFC-në, si dhe për përfundimin e duhur të çdo transaksioni.

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi "autorizim" nënkupton çdo miratim ose pëlqim të korporatës, kreditorëve dhe aksionarëve dhe çdo licencë ose miratim (e provuar në çdo mënyrë), regjistrim, arkivim ose përjashtim nga çdo departament, komision, autoritet, gjykatë, agjenci ose ent, ose bankë qendrore kombëtare, mbikombëtare, rajonale ose lokale, qeveritare, bashkiake, administrative ose gjyqësore (ose çdo person që ushtron funksionet e bankës qendrore, pavarësisht nëse është pronë shtetërore ose jo dhe pavarësisht si emërohet ose quhet).

11. Standardet e Performancës së IFC-së

a) IFC-ja kryen shërbimet me zellin e duhur dhe në mënyrë profesionale, në përputhje me ligjet dhe rregullat e zbatueshme. Në kryerjen e shërbimeve, IFC-ja do të veprojë si këshilltar besnik për Klientin dhe, kur është e zbatueshme dhe në shkallën që përfshihen palët e treta në një transaksion të mundshëm, do të veprojë me drejtësi ndërmjet Klientit dhe palëve të treta.

b) Në përmbushjen e shërbimeve të saj, IFC-ja u përmbahet ligjeve dhe rregulloreve përkatëse të Republikës së Shqipërisë dhe të atyre që hyjnë nën juridiksionin në të cilin kryhen shërbimet, ose shërbimet shkaktohen për t'u kryer nga IFC-ja. Rrjedhimisht, IFC-ja nuk do të ketë asnjë detyrim për mospërmbushje të çdo shërbimi në shkallën që kjo përmbushje do të rezultojë në shkeljen e këtyre ligjeve dhe rregulloreve. Për të shmangur çdo dyshim dhe pa cenuar përgjithësimin e sa më sipër, pjesëmarrja nga ana e IFC-së në çdo aktivitet që çon në ngritjen e fondeve të huas dhe aksioneve të zakonshme në juridiksione të caktuara, mund të kufizohet nga

disa kufizime të vendosura nga ligjet, rregullat dhe rregulloret e lëshuara nga çdo autoritet në këto juridiksione (duke përfshirë ligjet, rregullat dhe rregulloret për garancitë).

c) Klienti mban parasysht dhe bie dakord që, në përmbushjen e shërbimeve, IFC-ja mund të mbështetet dhe analizat dhe rekomandimet do të bazohen kryesisht në informacionin e siguruar ose që shkaktohet të sigurohet për IFC-në nga Klienti, si dhe mbi bazën e produktit të punës, përfshirë studimet, raportet, analizat dhe opinionet e Konsulentëve të Klientit dhe Konsulentëve të Kontraktuar nga IFC-ja, përfshirë konsulentë ndërkombëtarë dhe konsulentë lokalë ligjorë. Rrjedhimisht, IFC-ja mund të supozojë në mënyrë të arsyeshme që informacioni dhe produkti i punës është i saktë, i plotë, dhe i mjaftueshëm dhe nuk merr përsipër ta verifikojë atë në mënyrë të pavarur.

12. Forca madhore

IFC-ja nuk do të jetë në mospërmbushje të detyrimeve të saj në rastet kur përmbushja nga IFC-ja e shërbimeve vonohet ose parandalohet nga shkaqe që janë jashtë kontrollit të saj të arsyeshëm, duke përfshirë, por pa u kufizuar në forcat madhore, veprimet e qeverisë lokale, shtetërore ose federale, ose ndonjë instrumentalitet tjetër të saj, si: grevat, trazirat civile ose raste të tjera të ngjashme.

13. Raportet dhe dokumentet; përdorimi i emrit, markës tregtare ose logos së IFC-së

a) Të gjitha raportet, analizat, memorandumet dhe dokumentet e përgatitura nga ose me ndihmën e IFC-së, mund të shpërndahen nga Klienti sipas nevojave të punonjësit, nëpunësit dhe konsulentët, por nuk mund t'u shpërndahen palëve të treta pa pëlqimin me shkrim të IFC-së, përveç rasteve kur çdo memorandum, informacion, prospekt ose dokument tjetër, me synim për shpërndarje tek investitorët potencialë të cilëve mund t'u jepen këto dokumente, pasi të jenë pranuar, ratifikuar dhe miratuar nga Klienti si të vetat dhe me kusht që secila kopje që shpërndahet të përmbajë një njoftim të Klientit ose refuzim në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga IFC-ja.

b) Klienti bie dakord të mos përdorë ose të mos lejojë përdorimin e emrit, markës tregtare ose logos së IFC-së (marka), në asnjë reklamë, literaturë promovionale ose informacion,



sinjalistikë, materiale marketingu, broshura, deklarata për shtyp ose çdo material të ngjashëm publik në asnjë institucion mediatik, pa pëlqimin paraprak të IFC-së në çdo rast. Këto leje mund të jepen ose refuzohen, ose tërhiqen pasi të jenë dhënë fillimisht, në diskrecionin e vetëm të IFC-së.

c) Klienti bie dakord që nuk do të përdorë apo t'i referohet markës në ndonjë mënyrë që mund të çorientojë ose që pasqyron në mënyrë të pafavorshme reputacionin e IFC-së ose në çdo mënyrë që bie në kundërshtim me ligjin, rregullat dhe rregulloret e zbatueshme.

d) Klienti bie dakord që të mos bëjë ose publikojë asnjë deklaratë ose reklamë, e cila mund të përdoret për të dëmtuar imazhin, vlerat, identitetin, reputacionin ose mirëbesimin që lidhet me IFC-në.

e) Klienti bie dakord, të mos paraqesë ose lejojë paraqitjen e pikëpamjeve të IFC-së pa pëlqimin paraprak me shkrim të IFC-së. Pa u kufizuar në sa më sipër, Klienti bie dakord të mos ketë interes pronësie ose ndonjë të drejtë tjetër (duke nënkuptuar, prezumuar ose ndryshe), tërësisht ose pjesërisht, në logon ose çdo të dhënë të IFC-së, ose çdo informacion konfidencial për të marrë shërbime ose për të përdorur logon në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje. Klienti pranon të drejtën ekskluzive të IFC-së, të drejtën e titullit dhe interesit në dhe për logon, të dhënat e IFC-së dhe çdo informacion konfidencial, dhe në asnjë rast nuk do të shkaktojë apo bëjë që të shkaktohet ndonjë veprim që dëmton apo priret të dëmtojë ndonjë pjesë të këtyre të drejtave, titujve dhe interesave, dhe çdo raport, opinion ose dokument për të cilat ka kontribuar IFC-ja në faqen e internetit të Projektit, mbeten pronë e vetme e IFC-së. E vetmja e drejtë që i jepet Klientit, sipas seksionit 12, është që të përdorë logon vetëm siç lejohet në këtë Marrëveshje dhe në lidhje me këtë Marrëveshje dhe të mos përdoret për asnjë lloj qëllimi tjetër. I gjithë mirëbesimi që lind nga përdorimi i markës nga Klienti do të përdoret vetëm në dobi të IFC-së. IFC-ja rezervon të drejtën të përdorë logon në mënyrën në të cilën ajo ka vepruar përgjithësisht përpara kësaj Marrëveshjeje dhe në çdo mënyrë tjetër të ligjshme. Për të shmangur çdo dyshim, miratimi nga IFC-ja, i përdorimit të logos, nuk

do të ndikojë në të drejtën e IFC-së për t'u zhdëmtuar nga Klienti, nëse Klienti e përdor siç është parashikuar në seksionin 15.

14. Mospranimet dhe zhdëmtimet

a) Ndërsa IFC-ja do të bëjë përpjekjet e saj maksimale për të përmbushur shërbimet, IFC-ja nuk jep përfaqësim, garanci të hapur ose të nënkuptuar për saktësinë ose plotësinë, ose mjaftueshmërinë e raporteve, dokumenteve, analizave, memorandumëve, faqes së internetit të Projektit ose prospekteve, duke përfshirë çdo parashikim ose vlerësim që përmbahet këtu, i përgatitur me ndihmën e IFC-së ose të Konsulentëve të Kontraktuar nga IFC-ja, as edhe për shkallën e suksesit që mund të realizohet në zbatimin e çdo rekomandimi që përmbahet këtu ose në përpjekjen për të siguruar pjesëmarrjen e investitorëve potencialë nga Klienti, në zbatimin e Projektit ose sigurimin e ndonjë financimi.

b) Ndërsa IFC-ja do të bëjë përpjekje maksimale për përmbushjen e shërbimeve, IFC-ja nuk merr përsipër përfaqësimin ose garancinë për saktësinë ose plotësimin e faqes së internetit të Projektit ose çdo të dhënë apo opinion që përgatitet ose vendoset në faqe, nga ose me ndihmën e IFC-së ose Klientit, kur thuhet “SIÇ ËSHTË”. IFC-ja REFUZON TË GJITHA GARANCITË ME SHKRIM OSE ME GOJË, TË HAPURA OSE TË NËNKUPTUARA, PËRFSHIRË DHE PA KUFIZIM, GARANCITË E NËNKUPTUARA, PËRPUTHJEN PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR DHE MOSSHKELJEN E LIGJIT. Pa kufizim për sa më sipër, Klienti ka përgjegjësinë e vetme dhe ekskluzive në lidhje me faqen e internetit dhe funksionimin e saj për çdo veprim ose mosveprim të ndonjë ofruesi, shërbimi ose çdo këshilltari tjetër të përfshirë dhe për verifikimin e plotësisë dhe saktësisë të të gjithë informacionit që vihet në dispozicion në faqen e internetit të Projektit. IFC-ja nuk garanton që përdorimi i faqes së internetit do të jetë pa gabime.

c) IFC-ja nuk përgjigjet për asnjë humbje, kosto, dëme ose detyrime që Klienti ose çdo degë dhe filial, ose çdo aksionar përkatës i tij, ose huadhënës, ose investitor, ose investitor potencial, ose palë tjetër, mund të pësojë si rezultat i përmbushjes nga IFC-ja e shërbimeve ose si rezultat i përdorimit ose mbështetjes në



shërbimet e tilla ose në raportet, dokumentet, analizat, memorandumet, faqen e internetit të Projektit ose prospektet e përgatitura ose të shpërndara nga ose me ndihmën e IFC-së, ose çdo konsulentit të kontraktuar nga IFC-ja, përveç rasteve kur gjykata nën juridiksionin kompetent përcakton nga një vendim i formës së prerë që kjo humbje, kosto, dëm ose detyrime është shkaktuar për shkak të neglizhencës së rëndë ose shpërdorimit të qëllimtë nga ana e IFC-së.

d) IFC-ja nuk përgjigjet për asnjë shkelje të detyrimeve nga ana e ndonjë investitori, huadhënësi ose subjekti tjetër me të cilët Klienti ose çdo palë që caktohet nga Klienti, hyn në transaksion ose Marrëveshje në lidhje me shërbimet ose Projektin.

e) Klienti: i) do të zhdëmtojë ose do ta konsiderojë IFC-në të pafajshëm dhe do të paguajë, ose ndryshe rimbursojë, IFC-në për çdo humbje, pretendim, dëmtim, detyrim që IFC-ja dhe/ose Konsulentët e kontraktuar nga IFC-ja dhe/ose punonjësit përkatës, zyrtarët dhe agjentët mund të shkaktojnë ose mund t'i nënshtrohen, përfshirë, pa kufizim, rastet e një ankese ose padie të paraqitur kundër tyre nga një palë e tretë (e cila mund të jetë e lidhur apo jo me Klientin), mbi bazën e çdo lloj argumenti që lidhet me përmbushjen e shërbimeve nga IFC-ja ose që bazohet në çdo person ose send për çdo gjë që është bërë ose jo nga IFC-ja, përfshirë, por pa u kufizuar, në çdo pretendim ose detyrim ndaj çdo pale të tretë, bazuar në ose që rrjedh nga faqja e internetit dhe/ose përdorimi nga Klienti i logos ose të drejtave të dhëna për Klientin, sipas seksionit 14; dhe ii) do të rimbursojë IFC-në për çdo shpenzim, përfshirë dhe shpenzimet ligjore që janë llogaritur në mënyrë të arsyeshme nga IFC-ja, lidhur sa më sipër, duke marrë parasysh sidoqoftë që Klienti nuk është i detyruar mbi bazën e zhdëmtimit derisa gjykata e juridiksionit kompetent të përcaktojë në bazë të një vendimi të formës së prerë që këto humbje, ankesa, dëme ose detyrime janë si pasojë e një shpërdorimi të qëllimtë ose një neglizhence të rëndë nga IFC-ja.

f) Pavarësisht nga sa më sipër, detyrimi i IFC-së, nëse ka, ndaj Klientit nuk do të trajtohet si dëmtim indirekt, humbje e përfitimit ose humbje e mundësisë dhe as do të tejkalojë shumën e pagesave profesionale që ka marrë IFC-ja për llogari të saj në bazë të kësaj Marrëveshjeje. IFC-

ja nuk përgjigjet për asnjë dëmtim direkt, indirekt, të veçantë, aksidental, të vijueshëm ose dëme që burojnë nga përdorimi ose paaftësia për të përdorur faqen e internetit ose nga dhënia e shërbimeve. Këto përjashtime përdoren për çdo pretendim për humbje të fitimit, humbje të të dhënave, humbje të mirëbesimit, ndalimi të punës, mosfunksionimi të kompjuterit ose keqfunksionimi të kompjuterit ose çdo dëm tjetër tregtar ose humbje edhe në rastet kur IFC-ja duhet të kishte dijeni ose duhet të kishte pasur dijeni për mundësinë e shkaktimit të këtyre dëmeve.

g) IFC-ja rezervon të drejtën të marrë nën kontroll mbrojtjen e çdo pretendimi të një pale të tretë, që është subjekt i dëmshpërblimit nga Klienti dhe, në këtë rast, Klienti do të bashkëpunojë me IFC-në për pranimin e çdo mbrojtjeje të mundshme.

h) Duke pranuar detyrimin për të përmbushur këto shërbime, IFC-ja nuk ndërmerr asnjë angazhim ose ofertë të hapur ose të nënkuptuar, lidhur me investimin ose me sigurimin e burimeve financiare (qoftë këto për llogari të saj ose të të tjerëve) për Projektin, Klientin ose çdo palë të caktuar nga Klienti në lidhje me shërbimet e Projektit.

15. Hyrja në fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi në datën në të cilën IFC-ja merr pagesën e plotë sipas kësteve të referuara në paragrafin “a” të seksionit 4, dhe pas firmosjes së kësaj Marrëveshjeje. Klienti paraqet garancinë dhe konfirmon që ka marrë të gjitha autorizimet e kërkuara, në mënyrë që të hyjë në këtë Marrëveshje, kur Klienti i ka konfirmuar IFC-së dhe ka siguruar të dhëna të kënaqshme për IFC-në që Klienti ka marrë të gjitha autorizimet për të hyrë në këtë Marrëveshje, për të përmbushur të gjitha detyrimet e kësaj Marrëveshjeje, siç parashikohet, ka detyrim ligjor për të gjitha klauzolat, përfshirë detyrimin për të paguar pagesat dhe të ardhurat nga të gjitha pagesat që i detyrohet IFC-së.

16. Qasja në informacion – politika informuese

a) Palët bien dakord që qasja e IFC-së me Politikën Informuese (PI) të aplikohet në përputhje me gjithë dokumentacionin, të dhënat dhe çdo informacion tjetër që IFC-ja merr nga Klienti apo palët e treta në lidhje me biznesin



apo projektin e Klientit. Në bazë të PI-së, IFC-ja nuk e shpalosë në publik informacionin financiar, biznesi, pronësie apo informacionin jopublik që ajo ka marrë nga klientët e saj apo palë të treta, pa marrë për këtë pëlqimin e këtyre klientëve apo palëve të treta. Sipas PI-së, IFC-ja vë në dispozicion të publikut një informacion të caktuar rreth aktiviteteve të IFC-së. Shembuj të një informacioni të tillë në lidhje me aktivitetet e shërbimeve këshillimore të IFC-së përfshijnë praktikat më të mira apo raportet mbi mësimet e nxjerra që synojnë rritjen e ndikimit të zhvillimit të iniciativave të IFC-së dhe informacion të kufizuar për projekte të veçanta, si për shembull, përshkrime të shkurtër të Projektit, rreziqet e mundshme mjedisore dhe sociale, ndikimet e pritshme të zhvillimit dhe rezultatet aktuale. PI-ja është në dispozicion në faqen e internetit të IFC-së: www.ifc.org/Disclosure.

b) Në përputhje me PI-në, jo më vonë se 6 prilli 2015 IFC-ja do të shpalosë informacionin në lidhje me këtë Projekt nëpërmjet dokumentit të “Informacionit të Projektit” për Shërbimet Këshillimore të IFC-së (IPSK – emri në anglisht *Advisory Services Project Information Document*), duke e vendosur atë në InfoShopin e Grupit të Bankës Botërore, zyrat përkatëse lokale të Grupit të Bankës Botërore, si dhe nëpërmjet faqes së internetit të IFC-së. Teksti i IPSK-së që do të publikohet është bashkëngjitur si aneks 3.

c) IPSK-ja duhet të përditësohet herë pas here për të reflektuar ndryshimet materiale në përshkrimin e përgjithshëm të Projektit, ndikimet e pritura të zhvillimit apo rreziqet në rritje mjedisore apo sociale. Në raste të tilla, IFC-ja do të njoftojë Klientin, me shkrim, për përditësimet e propozuara para bërjes së tyre publike.

17. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

a) Palët do të përpiqen, në mirëbesim, të zgjidhin çdo mospajtim e mosmarrëveshje që rrjedh sipas ose që lidhet me këtë Marrëveshje, në mënyrë miqësore.

b) Nëse kjo zgjidhje miqësore nuk ekziston, të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga, ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhen përfundimisht në bazë të Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, nga një ose më shumë arbitra të caktuar në përputhje me këto rregulla. Vendi i arbitrazhit do të jetë Nju-Jork. Gjuha e arbitrazhit është

anglishtja.

c) Palët pranojnë e bien dakord që asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje apo Rregulla të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, as edhe paraqitja në arbitrazh nga ana e IFC-së, në asnjë mënyrë nuk përbën heqje dorë, ndërprerje apo ndryshim nga ana e IFC-së të ndonjë privilegji, imuniteti apo përjashtimi të benefiteve që IFC-ja ka bazuar në Marrëveshjen e IFC-së (*IFC's Articles of Agreement*), konventa ndërkombëtare apo ligj i aplikuar.

18. Amendamentet/ndryshimet

Çdo ndryshim ose heqje dorë, ose çdo miratim që është dhënë sipas çdo klauzole të kësaj Marrëveshjeje bëhet me shkrim ose, në rastet e një ndryshimi, nënshkruhet nga të dyja Palët.

19. Ruajtja e të drejtave

Asnjë veprim dhe asnjë mospërmbushje ose vonesë nga palët në ushtrimin e autoritetit, mjetit ligjor, diskrecionit, autoritetit ose të drejtave të tjera sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të dëmtojë ose nuk do të interpretohet të jetë heqje dorë ose pranim në heshtje në atë ose në kompetencë, mjet ligjor, diskrecion, autoritet ose të drejtë tjetër mbi bazën e kësaj Marrëveshjeje ose në ndonjë mënyrë përjashton të drejtën shtesë ose të ardhshme për t'u ushtruar.

20. Pasardhësit dhe Përfituesit

Kjo Marrëveshje detyron ligjërisht dhe i kalon si e drejtë pasardhësve dhe përfituesve përkatës të palëve, me kusht që asnjë nga palët të mos transferojë këtë Marrëveshje, në tërësi ose pjesërisht, pa aprovimin paraprak të palës tjetër.

21. Marrëveshja e plotë dhe kopjet

a) Kjo Marrëveshje, së bashku me anekset e saj, përbëjnë një marrëveshje të plotë ndërmjet palëve dhe i bën të pavlefshme të gjitha marrëveshjet e mëparshme, mirëkuptimet me gojë ose me shkrim midis palëve në lidhje me subjektin në fjalë. Nëse ndonjë nga termat e kësaj Marrëveshjeje do të quhet i pavlefshëm, joligjor ose i pazbatueshëm, vlefshmëria e termave të tjerë në këtë Marrëveshje nuk do të preket, dhe kjo Marrëveshje do të interpretohet dhe do të zbatohet, duke konsideruar që të tilla kushte të pavlefshme, joligjore dhe të pazbatueshme nuk kanë qenë të përfshira në këtë Marrëveshje.



b) Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në disa kopje, secila prej tyre është origjinale, por që të gjitha përbëjnë të njëjtën marrëveshje.

Në dëshmi të kësaj, palët që kanë bërë këtë Marrëveshje, nënshkruajnë në emrat e tyre përkatës mbi bazën e datës së shkruar më sipër.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga: _____

Emri: Ilir Beqaj

Titulli: Ministër

KORPORATA FINANCIARE
NDËRKOMBËTARE

Nga: _____

Emri: Thomas Lubeck

Titulli: Menaxher rajonal

Ballkani Perëndimor

ANEKS 1
SHËRBIMET

Faza I: Zhvillimi i Projektit – IFC-ja do të shqyrtojë dokumentet ekzistuese (historikun e dokumenteve) dhe studimet dhe do të supervizojë Konsulentët e kontraktuar nga IFC-ja për të përgatitur dhe rishikuar një ‘due diligence’ të plotë që do të përfshijë aspektet e mëposhtme të Projektit:

Ligjor – rishikim i kërkesave ligjore të nevojshme për zbatimin e Projektit, përgatitjen e dokumenteve draft për parakualifikimin, nëse garantohet, dhe udhëzimet për ofertuesit, marrëveshjet e funksionimit/investimit;

Teknik – rishikim i studimeve ekzistuese të parafizibilitetit dhe përcaktimi i kërkesës për të caktuar numrin optimal, kapacitetin dhe vendndodhjen e propozuar për laboratorët; të zhvillojë minimumin e kërkesave teknike dhe standardet e performancës për objektet/laboratorët;

Social dhe mjedisor – nënpolitikat e Grupit të Bankës Botërore, ndikimi social dhe mjedisor i Projektit duhet vlerësuar. Faktorët që përfshihen, por që nuk janë të limituar për rregullimin e krahut të punës dhe ndotjen;

Financiar – testimi/kërkimi fillestar për investitorë ndërkombëtarë, hartimi dhe mbikëqyrja e procesit të ankandit, zhvillimi i një modeli biznesi, përgatitja e një modeli vlerësimi që do t'i dorëzohet, në mënyrë konfidenciale

Klientit, për t'u përdorur në të ardhmen si referencë për vlerësimin e ofertave për Projektin.

Faza II: Zbatimi i Projektit – IFC-ja do të ndihmojë me identifikimin e një investitori / operatori të aftë për financim, ndërtim dhe funksionim të objekteve/laboratorëve në emër të Klientit:

Marketimi për investitorët – identifikimi i investitorëve/operatorëve të mundshëm; promovimi i Projektit për të dyja fazat; përgatitja e marrëveshjeve draft për funksionimin / investimin dhe i një memorandum informacioni; nëse është e nevojshme, organizimi i një prezantimi tek investitorët ndërkombëtarë; organizimi i vizitave në terren dhe takimet me menaxhimin;

Dokumentet e tenderit – Përgatitja e rregullave dhe procedurave për tenderin, si edhe çdo dokument tjetër ligjor, që mund të kërkohe në mbështetje të transaksionit (nëse është e nevojshme); organizimi i procesit të tenderit paralelisht për të dy tipat e objekteve, nëse është e mundur; rishikimi i kredencialeve të ofertuesve; përgatitja e raportit të tenderit, duke nënvizuar rekomandimet për Klientin;

Mbyllja tregtare – vlerësimi i secilës ofertë të paraqitur nga secili investitor privat i mundshëm dhe mbështetje Klientit gjatë negociatave; mbështetje gjatë firmosjes së koncesionit / marrëveshjes së investimit;

Mbyllja financiare – këshillimi i Klientit për të arritur mbylljen financiare.

ANEKS 2
PROGRAMI I PUNËS DHE TABELA
KOHORE

Shënim. Kjo tabelë kohore është vetëm për qëllime indikative; koha aktuale mund të ndryshojë.

Aktiviteti	Kohëzgjatja e pritshme
Firmosja e mandatit	muaj 0
Përzgjedhja e konsulentëve të jashtëm	muaj 1
Analiza financiare	muaj 2-5
Analiza ligjore	muaj 2-5
Analiza teknike	muaj 2-5
Promovimi i investitorëve	muaj 2-6
Dorëzimi i studimit të fizibilitetit	muaj 6



Aprivimi i studimit të fizibilitetit	muaj 7
Procesi i tenderit	muaj 7-10
Paraqitja e ofertave	muaj 10
Përzgjedhja e fituesit të tenderit	muaj 11
Firmosja e Kontratës PPP	muaj 12

ANEKS 3
DOKUMENTI I INFORMACIONIT TË
PROJEKTTIT TË SHËRBIMIT
KËSHILLIMOR (ASPI)

Politika Informuese për Publikun për Shërbimin Këshillimor

Përmbledhje

Numri i Projektit: 600511

Emri i Projektit: Albania Labs

Statusi: aktive

Rajoni: Evropë dhe Azi Qendrore

Vendi primar: Shqipëria

Vende të tjera:

Departamenti primar: Transaksionet Këshillimore për Partneritet Publik Privat

Data e fillimit të Projektit me përafërsi 2.5.2015

Data e përfundimit të Projektit me përafërsi: 2.5.2016

Data e aprovimit nga IFC-ja: 8/XX/2015

Aprovohet të informohet publiku më: XX/XX/201_

Ndikimi i pritshëm në zhvillim

Qëllimi i Projektit është modernizimi dhe përmirësimi i shërbimit laboratorik në spitalet e zgjedhura publike. Këto rezultate do të materializohen me pjesëmarrjen e sektorit privat, që do të institucionalizonte një rrjet laboratorik të integruar, investojë në pajisje dhe sistem të dedikuar informatik dhe mbajë një sistem të rreptë e cilësor menaxhimi.

Përshkrimi i Projektit

IFC-ja është zgjedhur si këshilltar kryesor për transaksionin për Ministrinë e Shëndetësisë të Shqipërisë për të prezantuar pjesëmarrjen e sektorit privat dhe tërhequr një investitor, i cili do të investojë në pajisjet laboratorike, do të fusë një sistem informatik të dedikuar dhe ofrojë shërbime laboratorike në përputhje me çmimet e krahasuara rajonale.

IFC-ja pritet të ofrojë këshillim të vazhdueshëm për transaksionin për Ministrinë e Shëndetësisë dhe mbështesë Ministrinë në procesin e përgjithshëm të menaxhimit të transaksionit deri në dhënien e kontratës së koncesionit, duke siguruar një proces tenderimi të drejtë dhe transparent dhe në përputhje me ligjet dhe rregullat e aplikuara.

Përshkrimi i standardeve të performancës dhe i zbutjes së ndikimit të mundshëm.

Standardi i performancës (SP)	Përshkrimi i ndikimit të mundshëm	Zbutja/lehtësimi
SP 1. Vlerësimi dhe menaxhimi i ndikimit dhe rreziqeve sociale mjedisore	Si pjesë e 'due diligences', dhe mandatuar nga politikat e IFC-së për zhvillimin e qëndrueshëm, IFC-ja e ka shqyrtuar këtë Projekt për të vlerësuar përputhshmërinë me standardet e performancës së IFC-së.	Këshillimi i IFC-së do të jepet në përputhje me parimet e standardeve përkatëse të performancës. Ekipi i IFC-së do të ndihmojë Klientin, si vendimmarrës final, të përfitojë të kuptuarit e standardeve të performancës së IFC-së. Do të jepet një përditësim i masave zbutëse/lehtësuese kur të fillojë Projekti dhe të firmosen kontratat përkatëse.
SP 2. Puna dhe kushtet e punës	Si pjesë e 'due diligences', dhe mandatuar nga politikat e IFC-së për zhvillimin e qëndrueshëm, IFC-ja e ka shqyrtuar këtë Projekt për të vlerësuar përputhshmërinë me standardet e performancës së IFC-së.	Këshillimi i IFC-së do të jepet në përputhje me parimet e standardeve përkatëse të performancës. Ekipi i IFC-së do të ndihmojë Klientin, si vendimmarrës final, të përfitojë të kuptuarit e standardeve të performancës së IFC-së. Do të



		jepet një përditësim i masave zbutëse kur të fillojë Projekti dhe të firmosen kontratat përkatëse.
SP 3. Eficienca e burimeve dhe parandalimi i ndotjes	Si pjesë e 'due diligences', dhe mandatar nga politikat e IFC-së për zhvillimin e qëndrueshëm, IFC-ja e ka shqyrtuar këtë Projekt për të vlerësuar përputhshmërinë me standardet e performancës së IFC-së.	Këshillimi i IFC-së do të jepet në përputhje me parimet e standardeve përkatëse të performancës. Ekipi i IFC-së do të ndihmojë Klientin, si vendimmarrës final, të përfitojë të kuptuarit e standardeve të performancës së IFC-së. Do të jepet një përditësim i masave zbutëse kur të fillojë Projekti dhe të firmosen kontratat përkatëse.
SP 4. Shëndeti, siguria dhe garancia e komunitetit	Si pjesë e 'due diligences', dhe mandatar nga politikat e IFC-së për zhvillimin e qëndrueshëm, IFC-ja e ka shqyrtuar këtë Projekt për të vlerësuar përputhshmërinë me standardet e performancës së IFC-së.	Këshillimi i IFC-së do të jepet në përputhje me parimet e standardeve përkatëse të performancës. Ekipi i IFC-së do të ndihmojë Klientin, si vendimmarrës final, të përfitojë të kuptuarit e standardeve të performancës së IFC-së. Do të jepet një përditësim i masave zbutëse kur të fillojë Projekti dhe të firmosen kontratat përkatëse.

LIGJ
Nr. 79/2015

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES
KUADËR TË HUAS NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, QË
PËRFAQËSON REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË, DHE BANKËS PËR
ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS
PËR PROJEKTIN E REHABILITIMIT TË
SPITALIT RAJONAL TË SHKODRËS,
FAZA E TRETË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese e marrëveshjes kuadër të huas ndërmjet Këshillit të Ministrave, që përfaqëson Republikën e Shqipërisë, dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës

për projektin e rehabilitimit të Spitalit Rajonal të Shkodrës, faza e tretë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9191, datë 27.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

CEB

Drejtoria e Përgjithshme për Huatë dhe Zhvillimin Social

Z. Shkëlqim Cani
Ministër i Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1
Tiranë, Shqipëri
Paris, 18 nëntor 2014

Lënda: Marrëveshja Kuadër e Huas F/P 1385 Add 4 (2007)

Referuar letrës suaj me Prot. 154801 të datës 17/11/2014



I nderuar Ministër Cani,

I referohemi kërkesës suaj të datës 17 nëntor 2014 në lidhje me Projektin e Rehabilitimit të Spitalit Rajonal në Shkodër-faza e tretë (F/P 1385 A (2007))

Nëpërmjet kësaj letre ju falënderojmë që na informuat se Qeverisë Shqiptare i është dhënë një kredi e butë, nëpërmjet së cilës do të zbatohet sistemi i regjistrimit të Spitalit Rajonal të Shkodrës dhe pranojmë kërkesën tuaj për rialokimin e fondeve përkatëse të CEB-it nga Komponenti. Ngritja e kapaciteteve në sistemin e regjistrimit për përmirësimin e situatës së reanimacionit të Spitalit të Shkodrës, për të mundësuar blerjen e pajisjeve për këtë spital.

Pas konsultimeve të brendshme, kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë se kërkesa juaj është pranuar në lidhje me ndryshimin e alokimit të huas së CEB-it. Ndërkohë, ju vëmë në dijeni se sapo të jetë gati plani i prokurimit, duhet t'i dërgohet CEB-

it për miratim përpara lançimit të ofertave.

Nëpërmjet kësaj letre konfirmojmë se CEB-i ka pranuar kërkesën tuaj për shtyrje të periudhës së alokimit dhe afatin e përfundimit deri më 31 dhjetor 2015.

Me respekt
Melanie Wisschollek
Drejtor i Departamentit për Mbështetjen e Opeacioneve

Thierry Poirrel
Drejtor i Përgjithshëm

Në shtojcën I, pika II, që i bashkëlidhet marrëveshjes kuadër të huas ndërmjet Këshillit të Ministrave, që përfaqëson Republikën e Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, për projektin e rehabilitimit të Spitalit Rajonal të Shkodrës-faza e tretë bëhet një rishpërndarje e fondeve sipas tabelës së mëposhtme:

Kategoritë që preken nga rishpërndarja e fondeve	Vlera para rishpërndarjes (EUR)	Shuma që kalon ndërmjet kategorive (shprehur në EUR)	Vlera pas rishpërndarjes (EUR)
Ndërtim kapacitetesh për sistemin e regjistrimit	310,000	-310,000	0
Pajisje mjekësore	0	+310,000	310,000
*Vlera e kategorive të tjera nuk ndryshojnë			

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 205 lekë